



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo -Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**  
**Sesioni pranveror**

Kryesia e Kuvendit  
P- 062  
Prishtinë, më 27 prill 2009, në orën 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 27 PRILL 2009**

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Nexhat Daci, Naim Maloku dhe Xhezair Murati, kurse munguan Ibrahim Gashi (me arsye) dhe Sllobodan Petroviq.

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ibrahim Makolli, Lulëzim Zeneli, Ardian Gjini, Mufera Sinik dhe Sllavisa Petkoviq.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skender Reçica, kurse nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Naim Abazi dhe Sherif Konjufca,

Nga OSBE- ja: Petrit Hysaj.

.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje. Ai propozoi edhe tri pika shtesë.

Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit të Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

### **R e n d i t e**

1. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës,
  2. Konfirmimi i Vendimit për lejimin e udhëtimit jashtë vendit,
  3. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-ve për lejimin e monitorimit të punës së Kryesisë së Kuvendit,
  4. Shqyrtimi i kërkesës për t'i ftuar anëtarët e Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar për vizitë Kuvendit,
  5. Shqyrtimi i kërkesës për t'i ftuar anëtarët e Komisionit për Vetëqeverisje Lokale e Rajonale dhe të Komisionit për Informim dhe Media të Parlamentit të Kroacisë për vizitë në Kuvendin e Kosovës
- 
1. **Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës**

Kryesia, pasi shqyrtoi rekomandimin e cekur më lart, nxori këtë

### **P Ë R F U N D I M**

1. Propozimi i Komisionit përzgjedhës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës radhitet, si pikë e tretë e rendit të ditës, për seancë plenare më 30 prill 2009.
2. Votimi për miratimin e propozimit për emërimin e anëtarëve të Bordit të Trustit Pensional të Kosovës bëhet në mënyrë elektronike.

### **2. Konfirmimi i Vendimit për lejimin e udhëtimit jashtë vendit**

**Kryesia**, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, konfirmoi këtë

### **V E N D I M**

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i delegacionit të Kuvendit, në përbërje: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti dhe Ibrahim Makolli në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, në Londër, prej 13 deri më 15 maj 2009.

2. Të gjitha shpenzimet e udhëtimit të delegacionit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.
3. Përktimi sigurohet në Londër, me shpenzime të Kuvendit të Kosovës.

### **3. Shqyrtimi i kërkesës së OJQ-ve për lejimin e monitorimit të punës së Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Transparenca në punimet e Kuvendit, si në seanca plenare, në mbledhje të komisioneve parlamentare, në debate publike për shqyrtimin e temave të caktuara, pastaj transmetimi i drejtpërdrejtë i punimeve të seancave plenare, publikimi i të gjitha dokumenteve të Kuvendit në faqen e internetit të Kuvendit etj., ua mundëson publikut të gjerë që të ketë qasje në punimet e Kuvendit.
2. Kryesia konstaton se monitorimi i mbledhjeve të Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Kosovës nga ana e OJQ-ve nuk i ndihmon efektivitetit të punës së saj. Procesverbalet dhe vendimet e Kryesisë publikohen në faqen e internetit të Kuvendit, në të cilat mund të ketë qasje çdokush që është i interesuar për të përcjellë punën e Kryesisë.

### **4. Shqyrtimi i kërkesës për t'i ftuar anëtarët e Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar për vizitë Kuvendit të Kosovës**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Ftohen anëtarët e Grupit të Miqësisë të Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar për të vizituar Kuvendin e Republikës së Kosovës.
  2. Shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit, sipas paragrafit një (1) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.
- 
6. **Shqyrtimi i kërkesës për t'i ftuar anëtarët e Komisionit për Vetëqeverisje Lokale e Rajonale dhe të Komisionit për Informim dhe Media të Parlamentit të Kroacisë për vizitë Kuvendit të Kosovës**

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **V E N D I M**

1. Ftohen anëtarët e Komisionit për Vetëqeverisje Lokale e Rajonale dhe të Komisionit për Informim dhe Media të Parlamentit të Kroacisë që të vizitojnë Kuvendin e Republikës së Kosovës

2. Shpenzimet e akomodimit dhe të qëndrimit, sipas paragrafit një (1) të këtij Vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit,  
**Jakup KRASNIQI**

---

Hartoi: **Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**